



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 249/3 Prot.

Tiranë, më 20.07.2026

V E N D I M

Nr. 199, Datë 20.07.2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën nr. 253, datë 31.10.2025, të paraqitur nga Fondacioni Së Bashku, përfaqësuar nga znj.S.L, Drejtore Ekzekutive kundër Bashkisë Kavajë, ku pretendohet diskriminim i personave me aftësi të kufizuara. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O N:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese parashtron se, Bashkia Kavajë ka ndërtuar rrethrotullimin e ri në Golem, i cili shërben edhe si park, sepse ka pemë dhe stola, por edhe si vend për ngjarje artistike në ajër të hapur gjatë verës. Ky investim i ri, në kundërshtim me atë që parashikon ligji, nuk është i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara, sepse:

- Nuk ka vende parkimi të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara;
- Nuk ka rampa;
- Trotualet nuk janë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara
- Nuk ka elementë aksesueshmërie për personat me aftësi të kufizuara në shikim.

Përfundimisht pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe përmirësimin e situatës në mënyrë që të jetë e aksesueshme për komunitetin dhe për personat me aftësi të kufizuara.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për

¹ Në vijim referuar me LMD.

² Në vijim referuar me Komisioneri.

çështje që lidhen me interesa kolektive. Konkretisht në këtë dispozitë sanksionohet sa vijon: “1. Komisioneri ka kompetencë: ... b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 1535/1 prot., datë 13.11.2025, Komisioneri ka kërkuar informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen nga Bashkia Kavajë, si subjekte kundër të cilit është paraqitur ankesa. Bashkia Kavajë ka marrë dijeni për këtë shkresë, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar Nr. RR808983647AA administruar në dosje, por nuk ka kthyer përgjigje.
2. Me shkresën nr. 1535/2 prot., datë 17.12.2025, Komisioneri i është drejtuar sërish Bashkisë Kavajë, me një kërkesë të përsëritur për informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen.

Në shkresën e sipërpërmendur, Komisioneri i bën kujtesë subjektit, për të dërguar informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke i sjellë në vëmendjen se mosplotësimi i kësaj kërkesë, përbën shkelje të dispozitave të LMD-së. Bashkia Kavajë ka marrë dijeni për shkresën nr. 1535/2 prot., datë 17.12.2025, më datën 19.12.2025, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar me Nr. RR805598619AA, por nuk ka kthyer përgjigje.

3. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”, si dhe për të administruar informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar si dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr. 151 prot, datë 15.01.2025, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 26.01.2026.

Bashkia Kavajë nuk u paraqit në seancë dëgjimore dhe nuk depozitoi informacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ankesës, të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri.

4. Me vendimin nr.23, datë 02.02.2026, Komisioneri vendosi të gjobisë Bashkinë Kavajë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr.253, datë 31.10.2025.

5. Me shkresën nr.590/1 prot., datë 16.2.2026, Bashkia Kavajë, parashtroi se, projektimi dhe realizimi i investimit në rrethrotullimin e ri të Golemit, është kryer nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ndërsa Bashkia Kavajë është në cilësinë e institucionit përgjegjës për mirëmbajtjen.

Në vijim të angazhimit të saj institucional, Bashkia Kavajë informoi se do të marrë masa për të mundësuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në zonën e rrethrotullimit të Golemit. Bashkia Kavajë informon se, aktualisht po hartohet një projekt për rikualifikimin e segmentit rrugor ndërmjet dy rrethrotullimeve që lidhin këtë aks, në kuadër të të cilit do të trajtohet dhe çështja e aksesueshmërisë.

6. Me shkresën nr.605 prot., datë 25.03.2026, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Kavajë, dokumentacionin përkatës i cili provon pretendimin se projektimi dhe investimi nuk është kryer nga ana e bashkisë por nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si dhe kopje të projektit që Bashkia Kavajë ka hartuar për rikualifikimin e segmentit rrugor në kuadër të të cilit do të trajtohet edhe çështja e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, afatet kohore për realizimin /zbatimin e këtij projekti, si dhe fondet e miratuara për realizimin e projektit.
7. Me shkresën nr. 590/1 prot., datë 07.04.2026, Bashkia Kavajë, vendosi në dispozicion dokumentacionin për projektin e emërtuar “Rikualifikimi i segmentit rrugor në zonën turistike Golem”, Faza II. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion sipas kësaj shkrese, rezulton se, Fondi Shqiptar i Zhvillimit është autoriteti zhvillues i këtij projekti, ndërsa Bashkia Kavajë është në cilësinë e përfituesit të këtij investimi. Bashkia Kavajë nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar në lidhje me projektin e hartuar, afatet kohore dhe fondet financiare të planifikuara garantimin e aksesueshmërisë në segmentin rrugor objekt shqyrtimi, rrethrotullimi i Golemit.
8. Me vendimin nr. 97, datë 20.04.2026, Komisioneri vendosi zgjatjen e afateve procedurale për shqyrtimin e ankesës me nr. 253 Regj., datë 31.10.2025, me jo më shumë se 90 ditë të tjera, nga data e marrjes dijeni të këtij vendimi.
9. Me shkresën nr.416/2 prot., datë 28.04.2026, Komisioneri iu drejtua Fondit Shqiptar të Zhvillimit me kërkesë për informacion, në lidhje me projektin e emërtuar “Rikualifikimi i segmentit rrugor në zonën turistike Golem”, Faza II.
10. Me shkresën nr. 748/3 prot., datë 12.05.2026 (administruar pranë Komisionerit me nr.416/3 prot., datë 25.05.2026), Fondi Shqiptar i Zhvillimit informoi se, rrethrotullimi i Golemit, nuk ka qenë i përfshirë në projektin për rikualifikimin urban të zonës turistike Golem-Lot II, të cilit i referohet Bashkia Kavajë, dhe ku Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka luajtur rolin e Agjencisë Zbatuese.

11. Në vijim të këtij informacioni, me shkresën nr. 748/2 prot., datë 05.06.2026, Komisioneri iu drejtua Bashkië Kavajë, duke kërkuar qendrimin e saj në lidhje me informacionin e depozituar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i cili mohon se rrethrotullimi i Golemit, ka qenë pjesë e projektit “Rikualifikimi i segmentit rrugor në zonën turistike Golem”, Lot II. Bashkia Kavajë, nuk ka kthyer përgjigje dhe nuk ka vendosur në dispozicion të Komisionerit informacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ankesës, ndërkohë që infrastruktura e cila është objekt shqyrtimi, është në juridiksionin e Bashkisë Kavajë, sikurse konfirmohet nga vetë kjo e fundit.

III. Pas kryerjes së hapave të mësipërm proceduralë, Komisioneri çmon se:

Bashkia Kavajë, si subjekt kundër të cilit është paraqitur ankesa nr. 253, datë 31.10.2025, që i përket palës ankuese Fondacioni Së Bashku, me dijeninë e plotë nuk ka mbështetur Komisionerin në ushtrimin e kompetencës së tij ligjore për të shqyrtuar ankesat për diskriminim, të përcaktuar në nenin 32/1/b, të LMD-së duke mos dhënë informacionin dhe dokumentacionin e plotë të kërkuar nëpërmjet shkresave nr.605 prot., datë 25.03.2026 dhe nr. 748/2 prot., datë 05.06.2026.

Duke mos dhënë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri, Bashkia Kavajë nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 32/2, të LMD-së, sipas të cilit: “2. *Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij.*” Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33/13, të LMD-së shoqërohet me marrjen e masës administrative, gjobë.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Bashkia Kavajë, është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 32, pika 2, të LMD-së, shkelje e cila sipas nenit 33/13, të po këtij ligji, është e dënueshme me gjobë.

Për personat juridik, siç është në rastin konkret është Bashkia Kavajë, neni 33, pika 13, të LMD-së, përcakton shkrehimisht: “Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”:..... b) personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;.....”

Në lidhje me përcaktimin e masës së gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të LMD-së, ku sanksionohet se: “12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni.”

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e mësipërme për përcaktimin e masës së gjobës dhe bazuar në faktin që, e drejta e pretenduar nga pala ankuese, sikurse është e drejta për aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara si dhe faktin që nga ana e Bashkisë Kavajë është treguar mungesë e përsëritur bashkëpunimi me Komisionerin për sigurimin e informacionit të nevojshëm për shqyrtimin e ankesës, Komisioneri, arrin në përfundimin se, Bashkia Kavajë duhet të gjobitet me 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “ç” dhe pika 2, nenin 33, pikat 11, 12, 13, germa “b”, 14, 18, si dhe nenin 33/1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Bashkia Kavajë, të gjobitet në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr.253, datë 31.10.2025.
2. Gjoka të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda një muaji nga marrja dijani, mbi masën administrative. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
3. Dërgimi i informacionit të kërkuar, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sjell shfuqizimin e gjobës.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)